

Syllabus i lëndës

Lënda: Historia e së Drejtës së Sheriatit

Programi i studimit: Teologji Islame

Numri i ECTS kredive: 4 ECTS Kredi

Niveli dhe lloji i lëndës: Zgjedhore

Kodi i lëndës: 106

Fondi i orëve: 2+0

Semestri: I-rë

Arsimtari i lëndës: Dr. Ajni Sinani

Viti akademik: 2024/2025

Telefoni: 044 148 286; **E-mali adresa:** ajnisinani@hotmail.com

Qëllimi i lëndës

Qëllimi i kësaj lënde është që të hulumtohen fillet, zhvillimet, kahet, rrjedhat, karakteristikat dhe veçoritë kryesore të Drejtës Islame. Të fillohet me studimin e së Drejtës në aspektin historik në Evropë duke u fokusuar tek shkolla e jurisprudencës normative, shkolla historike, sociologjike, realiste dhe shkolla e të drejtës natyrore. Më pas të trajtohen etapat dhe periudhat nëpër të cilat ka kaluar e drejta e Sheriatit. Të njihen shkollat e hershme juridike, themeluesit dhe personalitet e këtyre shkollave, pastaj periudha e pasimit të shkollave juridike, rrethanat politike e shoqërore, në periudhën emevite, abasite, osmane dhe deri deri në ditët tona. Të nxiten debate dhe të zhvillohen diskutime, përmes pikëpamjeve dhe botëkuptimeve të ndryshme me qëllim që të stimulohet tek studenti mënyra e të menduarit kritik.

Përmes argumenteve shkencore, fakteve dhe dëshmimeve historike, me metodë analitike dhe mendime kritike të vlerësohet rëndësia dhe kontributi i së Drejtës së Sheriatit në kuadër të së drejtës në tërësi. E Drejta e Sheriatit si rezultat i vazhdueshmërisë së saj prej 14 shekujsh, shtrirjes së gjerë dhe ndikimit të madh në mesin e shumë popujve të botës, vlerave dhe specifikave që posedon, i ka kontribuar të drejtës së përgjithshme. Prandaj studimi i saj është me vlerë jo vetëm për popujt muslimanë por edhe nga studiuesit e së drejtës kudo në botë.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të këtij cikli të ligjëratave studenti do të jetë në gjendje që:

- Të shpjegoj fillet dhe etapat e zhvillimit të Drejtës së Sheriatit
- Të njoh burimet dhe zhvillimin e të Drejtës së Sheriatit
- Të dalloj karakteristikat dhe veçoritë e të Drejtës së Sheriatit
- Të diskutoj në mënyrë shkencore vlerat dhe rëndësinë e të Drejtës së Sheriatit
- Të provoj arsyet dhe nevojën e njohjes së Historisë të Drejtës së Sheriatit nga studiues të ndryshëm në përgjithësi dhe studiuesit e Islamit në veçanti.

Metodologjia e mësimdhënies:

- Mësimdhënia do të zhvillohet në formën ligjëratash.
- Me nxitjen dhe stimulimin e debateve.
- Me përfshirjen e studentëve në diskutime,
- Përmes punimeve të seminareve dhe kollokfiumeve.

Përmbajtja e lëndës:

Java e parë: Vërejte të përgjithshme mbi historinë e së drejtës. Veçoritë e konceptit islam të së drejtës, krahasimi me teorinë juridike të shkollave juridike evropiane.

Literatura: Mr. Fikret Karcic, Historia e së Drejtës së Sheriatit, Prizren, 1994, f. 9-13.

Java e dytë: Traditat juridiko-historike në shkencën sheriato-juridike.

Literatura: Mr. Fikret Karcic, Historia e së Drejtës së Sheriatit, Prizren, 1994, f. 15-18.

Java e tretë: Rrjedhat kryesore të zhvillimit të shkencës dhe praktikës juridike të shariatit.

Literatura: Mr. Fikret Karcic, Historia e së Drejtës së Sheriatit, Prizren, 1994, f. 16-19.

Java e katërt: Periodizimi i historisë së të Drejtës së Sheriatit dhe institucionet shoqëror-juridike në Arabinë paraislame.

Literatura: Mr. Fikret Karcic, Historia e së Drejtës së Sheriatit, Prizren, 1994, f. 15-18;

Omer Sulejman El Eshekar, Historia e Fikhut, Nun, Shkup, 1426/2005, f. 47-53.

Java e pestë: Periudha e legjislacionit, rrethanat shoqërore-historike.

Literatura: Mr. Fikret Karcic, Historia e së Drejtës së Sheriatit, Prizren, 1994, f. 29-30;

D. Muhamed Jusri Ibrahim, Tarihu Et Teshri, Xhede, 1425/2005, f. 12-17.

Java e gjashtë: Burimet e së drejtës.

Literatura: Seid Ramadan, E drejta islame, burimi dhe zhvillimi, Logos-A, Shkup, 2007, f. 25-30; Mr. Fikret Karcic, Historia e së Drejtës së Sheriatit, Prizren, 1994, f. 31-37.

Java e shtatë: Periudha e Hulefai Rashidinëve, rrethanat shoqërore dhe burimet e së drejtës.

Literatura: Mr. Fikret Karcic, Historia e së Drejtës së Sheriatit, Prizren, 1994, f. 39-41.

D. Muhamed Jusri Ibrahim, Tarihu Et Teshri, Xhede, 1425/2005, f. 135-140.

Java e tetë: Ixhtihadi i ashabëve, traditat e vendeve të çliruara dhe aplikimi i së drejtës.

Literatura: Seid Ramadan, E drejta islame, burimi dhe zhvillimi, Logos-A, Shkup, 2007, f. 76-85; Mr. Fikret Karcic, Historia e së Drejtës së Sheriatit, Prizren, 1994, f. 41-49.

D. Muhamed Jusri Ibrahim, Tarihu Et Teshri, Xhede, 1425/2005, f. 141-143.

Java e nëntë: Periudhat e shkollave të hershme juridike;

Rrethanat shoqërore-historike dhe burimet e së drejtës.

Literatura: . Fikret Karcic, Historia e së Drejtës së Sheriatit, Prizren, 1994, f. 51-54.

Java e dhjetë: Shkolla e Hixhazit (Medines) dhe shkolla e Irakut (Kufes) dhe karakteristikat e përgjithshme të shkollave të hershme.

Literatura: . Fikret Karcic, Historia e së Drejtës së Sheriatit, Prizren, 1994, f. 54-58;

D. Muhamed Jusri Ibrahim, Tarihu Et Teshri, Xhede, 1425/2005, f. 180-184.

Java e njëmbëdhjetë: Periudha klasike e shkollave juridike.

Shkolla Hanefite, Malikite, Shafite dhe Hambelite.

Literatura: Fikret Karcic, Historia e së Drejtës së Sheriatit, Prizren, 1994, f. 61-75.

Java e dymbëdhjetë: Shkollat e zhdukura, interpretimi juridik i Havarixhve dhe i Shijave

Literatura: Fikret Karcic, Historia e së Drejtës së Sheriatit, Prizren, 1994, f. 77-87.

Java e trembëdhjetë: Periudha e rrumbullakimit të interpretimit të së drejtës

Rrethanat shoqëror-historike dhe shkencë juridike

Literatura: Fikret Karcic, Historia e së Drejtës së Sheriatit, Prizren, 1994, f. 89-91.

Java e katërbëdhjetë: Përfaqësuesit e shkollave juridike dhe marrëdhëniet ndërmjet shkollave juridike.

Literatura: Fikret Karcic, Historia e së Drejtës së Sheriatit, Prizren, 1994, f. 93-100.

Literatura obliguese:

- Fikret Karcic, Historia e së Drejtës së Sheriatit, Prizren, 1994.
- Historia e të Drejtës islame, Hayreddin karaman, Logos A, Shkup Prishtinë Tiranë, 2014.
- D. Muhamed Jusri Ibrahim, Tarihu Et Teshri, Xhede, 1425/2005.
- Omer Sulejman El Eshekar, Historia e Fikhut, Nun, Shkup, 1426/2005.
- Seid Ramadan, E drejta islame, burimi dhe zhvillimi, Logos-A, Shkup, 2007.
- Prof. Dr. Muhamed Seid Ramadan El Buti, Jomedhhebizmi, Tetova 1423/2002.
- Taha Xhabir El Ulvani, Kultura e dialogut në Islam, Logos-A, Shkup, 2000/1421.

Kriteriumi dhe komponentet e vlerësimit:

Pjesëmarrja: 10 pikë

Punimi seminarik dhe aktiviteti gjatë orës: 20 pikë

Vlerësimi i testit të parë: 30

Provimi final: 40 pikë

Gjithsej: 100 pikë

Standardi i notimit në FSI:

10= 90% - 100% -shkëlqyeshëm

9= 80 – 89 - shumë mirë

8=70 – 79 - mirë

7=60 – 69 - mjaftueshëm

6=50 – 59 - pamjaftueshëm

Kontributi në ngarkesën e studentit

Aktiviteti	Orë	Ditë\Javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime (teorike)	1	5	5
Përgatitja për kolloqfium	-	-	-
Konsultime	1	5	5
Testi, punë sem.	1	10	10
Detyra të shtëpisë	2	2	4
Mësimi individual (bibl. ose shtëpi)	-	-	5
Përg. për provim final	1	5	5
Koha e vlerësimit	2	2	4
Projektet, prezantimet	1	7	7
Totali		15 javë	75 orë